

Vendim nr. 165, datë 22.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 22.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SINAN TAJAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.
Shfuqizimi i nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.
Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4137 (350), datë 24.09.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
Shfuqizimi i vendimit nr. 98 (86-2024-2394), datë 13.12.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 17, 18, 42, 43, 124, 131, shkronja “f” dhe 134, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi i parë, 13, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; nenet 27, 45, 49, pika 3, shkronja “e”, 51/a, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka aplikuar tetë herë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (*KED*), në periudhën 2019 – 2024, për vendet vakante të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) të shpallura nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës. *KED*-ja ka verifikuar kushtet dhe kriteret e kandidimit të kërkuesit bazuar në dispozitat e Kushtetutës, Ligjin Organik të Gjykatës, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar (*Ligji për Qeverisjen e Drejtësisë*) dhe vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të *KED*-së “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar (*Vendimi për Procedurat e Verifikimit*).

2. Në të gjitha rastet, *KED*-ja ka ndaluar kandidimin e kërkuesit, konkretisht me vendimet nr. 79, datë 30.07.2019, nr. 80, datë 30.07.2019, nr. 81, datë 30.07.2019, nr. 82, datë 30.07.2019, nr. 30, datë 05.10.2020, nr. 3, datë 31.08.2021, nr. 9, datë 31.08.2021 dhe nr. 1, datë 20.01.2025. Vendimet e ndalimit të kandidimit janë kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga kërkuesi. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimet nr. 200, datë 22.08.2019, nr. 90, datë 06.11.2020 dhe nr. 61, datë 31.08.2021, ka vendosur rrëzimin e padive, me arsyetimin se nuk konstatoheshin shkelje të rënda procedurale në dhënien e vendimit nga *KED*-ja, që është shkaku i vetëm që përlligj vënien në diskutim të vendimeve të saj. Sipas kërkuesit, padia për kundërshtimin e vendimit të ndalimit e vitit 2025 është duke u shqyrtuar nga gjykatat e zakonshme.

3. Përveç padive për kundërshtimin e vendimeve të ndalimit, kërkuesi në datën 08.10.2020 ka ngritur padi në gjykatë për shfuqizimin e Vendimit për Procedurat e Verifikimit. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 57, datë 30.09.2022, ka vendosur mospranimin e padisë, me arsyetimin se kërkuesi, si individ, nuk legjitimohej për ngritjen e saj, pasi vendimi i kundërshtuar ishte akt nënligjor normativ. Ndonëse kërkuesi ka ushtruar rekurs, vendimi është lënë

në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2054(176), datë 12.05.2023, me argumentin se ishte në përputhje me ligjin procedural, jurisprudencën e konsoliduar të vet kolegjit dhe standardet kushtetuese.

4. Në vijim, në datën 25.10.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit për Procedurat e Verifikimit, të nenit 238 të Ligjit për Qeverisjen e Drejtësisë dhe të dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Ai ka pretenduar se: (i) vendimi i KED-së cenonte të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimeve të objektivitetit, të barazisë përpara ligjit, të kontradiktoritetit, të mosdiskriminimit dhe sigurisë juridike, si dhe standardin e arsytimit; (ii) neni 238 i ligjit cenonte të drejtën e ankimit, parimet e pavarësisë, paanshmërisë, objektivitetit, ligjshmërisë dhe transparencës; (iii) vendimet gjyqësore i cenonin të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit, së drejtës për mbrojtje efektive, së drejtës për gjykim të drejtë dhe standardit të arsytimit të vendimit.

5. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 23, datë 05.02.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi ankimi nuk përmbante kërkime ndaj vendimeve administrative individuale të dala në zbatim të tyre për ndalimin e kandidimit të tij. Sipas Kolegjit, vendimet e KED-së për ndalimin e kandidimit ishin aktet që kishin efekt të drejtpërdrejtë ndaj interesave të kërkuesit, megjithatë ai nuk i kishte kundërshtuar ato në ankimin kushtetues individual.

6. Në datën 27.11.2024 kërkuesi ka paraqitur sërish ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e nenit 238 të Ligjit për Qeverisjen e Drejtësisë. Ai ka pretenduar se dispozita ligjore i cenonte të drejtën për proces të rregullt ligjor, parimin e sigurisë juridike, barazinë përpara ligjit, të drejtën e ankimit dhe parimin e diskriminimit për shkak të statusit të veçantë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 24, datë 31.01.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi nuk justifikonte interesin real dhe të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e normës juridike.

7. Ndërkohë në datën 05.11.2024 kërkuesi i është drejtuar edhe Gjykatës Administrative të Apelit me padi për detyrimin e KED-së për të ndryshuar Vendimin për Procedurat e Verifikimit. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 98 (86-2024-2394), datë 13.12.2024, ka vendosur përsëri mospranimin e padisë, me arsyetimin se ligji nuk lejonte individin të kundërshtonte një akt normativ. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur rekurs të veçantë, vendimi është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4137 (350), datë 24.09.2025. Sipas

Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk legjitimohet në kundërshtimin e akteve nënligjore që përmbajnë rregullime abstrakte dhe ai (kërkuesi) ka mënyra të tjera për t'i parashtruar me padi pretendimet e tij për kundërligjshmërinë e aktit normativ, duke kundërshtuar aktin individual që dilte në zbatim të normës nënligjore.

8. Në datën 02.03.2026 kërkuesi i është drejtuar për herë të tretë Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 09.03.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:

9.1.1. *E drejta e aksesit në drejtësi*, pasi neni 238 i ligjit i ka kufizuar kontrollin e plotë gjyqësor për vendimet e KED-së lidhur me procesin e vlerësimit të kandidaturës së tij për pozicionin e gjyqtarit kushtetues. Praktika e Gjykatës Administrative të Apelit e ka konsoliduar këtë kufizim, duke vendosur se shqyrtimi gjyqësor për faktet që nuk sjellin pavlefshmëri absolute të akteve është i pamundur. Refuzimi i gjykatës për të shqyrtuar paditë e kërkuesit vjen si rezultat i vet ligjit që qartësisht ka kufizuar gjykatën të ushtrojë kontroll të plotë gjyqësor. Kufizimi i aksesit ka cenuar ndalimin e diskriminimit të kërkuesit për shkak të statusit të tij si person me aftësi të kufizuara, si dhe integritetin moral dhe reputacionin e tij në opinionin publik për shkak të supozimeve për ligjshmërinë e pagesave të doktoraturës.

9.1.2. *E drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi kufizimi ligjor i aksesit në gjykatë cenon edhe të drejtën për garë të barabartë dhe të drejtë, duke e privuar kërkuesin nga mbrojtja efektive e të drejtave të tij ligjore në procesin e konkurrimit për një post publik. KED-ja ka shkelur të drejtat e tij për të garuar dhe për t'u vlerësuar sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor. Atij i është mohuar e drejta për të parashtruar kundërshtimet ndaj vendimmarrjes së KED-së, si dhe për të korigjuar shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij themelore, përfshirë të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të statusit të tij si person me aftësi të kufizuara.

- 9.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi statusi i të verbrit, që ka kërkuesi, krijon detyrime shtesë për organet publike për të siguruar mbrojtje dhe mundësi të barabarta në garat për pozicionet publike. KED-ja e ka ndaluar kërkuesin të kandidojë për shkak të statusit, pasi pagesat e doktoraturës nuk përbëjnë shkelje të ligjit dhe duhet të vlerësohen në kuadër të statusit të tij të veçantë. Vlerësimi i përfitimeve të veçanta për shkak të statusit si të paligjshme përbën diskriminim. Kufizimi ligjor për të mos kundërshtuar vendimet e KED-së e privon kërkuesin nga mundësia për të kërkuar trajtim të barabartë përpara ligjit. Kufizimi krijon diferencime të pajustificueshme midis kandidatëve të përjashtuar dhe atyre që avancojnë në procesin e vlerësimit. Mungon një mekanizëm i besueshëm ligjor për kontrollin e procesit të vlerësimit të kriterëve, si dhe trajtimin e barabartë të të gjitha palëve pjesëmarrëse.
- 9.3. *Parimi i sigurisë juridike*, i garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi ndalimi me ligj i gjykatës për të ushtruar kompetencat kushtetuese shkel kufijtë dhe bazën e veprimtarisë së shtetit. Neni 238 i ligjit ka ndërhyrë në kompetencat e gjykatës për të ushtruar kontroll gjyqësor mbi veprimtarinë e organit publik. Ndërhyrja ka ulur besimin e individëve në sistemin e drejtësisë dhe ka minuar stabilitetin e rregullave ligjore, pasi i jep autoritet pothuajse absolut dhe të pakufizuar KED-së, duke krijuar precedent të rrezikshëm për shtetin e së drejtës.
- 9.4. *Parimi i publicitetit të procesit*, i garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi procedura e verifikimit nga KED-ja është e mbyllur dhe konfidenciale, pa pjesëmarrjen e kandidatit dhe pa mundësi për publikun ose për një organ të jashtëm të monitorojë vlerësimin. Mungesa e transparencës ka dëmtuar drejtpërdrejt interesat e kërkuesit, duke mos pasur dijeni të plotë as për arsyet e përjashtimit, as për mënyrën reale të vlerësimit të kriterëve. Kjo i ka hequr mundësinë për të sqaruar çështjet e diskutueshme para se KED-ja të merrte vendimin për ndalimin e kandidaturës së tij.
- 9.5. *E drejta e ankimit*, e garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, pasi neni 238 i ligjit ndalon mundësinë e ushtrimit të rekursit në Gjykatën e Lartë. Kushtetuta nuk lë hapësira për interpretime *latu sensu* ose për vendime arbitrare të ligjvënësit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuës

10. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individidi, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71 të Ligjit Organik të Gjykatës mund të paraqesë ankesë kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore. Një prej këtyre të fundit përcaktohet si kriter paraprak nga neni 31/a, pika 2, shkronja “dh”, i Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Gjykata ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës të të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes kërkesës së dytë, brenda afatit ligjor të parashikuar nga Ligji Organik i Gjykatës, ai ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Natyra kumulative e kriterëve paraprake të legjitimit do të thotë se mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuësin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

12. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e dy kriterëve paraprake, duke verifikuar, së pari, nëse kërkuesi justifikon interesin (legjitimimi *ratione personae*) dhe, së dyti, nëse kërkimet janë objekt i vendimeve të mëparshme (*gjëja e gjykuar*).

13. *Së pari*, lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individidi është subjekt i kushtëzuar dhe duhet të justifikojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Ai mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij,

duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me 3 kërkime: (i) shfuqizimin e nenit 238 të Ligjit për Qeverisjen e Drejtësisë; (ii) shfuqizimin e Vendimit për Procedurat e Verifikimit; (iii) shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, me të cilat është rrezuar padia e tij për ndryshimin e Vendimit për Procedurat e Verifikimit.

15. Neni 238 i Ligjit për Qeverisjen e Drejtësisë parashikon rregullat për ankimin kundër vendimit për ndalimin e kandidimit. Ankimi bëhet në Gjykatën Administrative të Apelit dhe vetëm për shkelje të rënda (*pika 1*) dhe se vendimi i gjykatës në këtë rast është përfundimtar dhe i formës së prerë (*pika 2*). Ndërsa Vendimi për Procedurat e Verifikimit përcakton, ndër të tjera, rregulla të hollësishme lidhur me procedurat që KED-ja zhvillon për verifikimin e pasurisë, integritetit, së shkuarës profesionale dhe personale, si edhe të kushteve e kriterëve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u zgjedhur në pozicionet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në zbatim të tij, KED-ja kryen procedurën e verifikimit dhe në përfundim nxjerr vendime për kualifikimin ose jo të kandidatëve.

16. Kërkuesi ka kandiduar disa herë për pozicionet vakante të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese, por në çdo rast kandidimi i tij është ndaluar nga KED-ja, bazuar në Vendimin për Procedurat e Verifikimit. Sipas nenit 238 të Ligjit për Qeverisjen e Drejtësisë, ai ka ngritur disa padi në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kundërshtuar vendimet e ndalimit të kandidimit. Ndërkohë, ai ka zgjedhur që me padi të veçantë t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit për të kundërshtuar Vendimin për Procedurat e Verifikimit, por padia e tij nuk është pranuar për shqyrtim me arsyetimin se individi nuk lejohet nga ligji të kundërshtojë veçmas një akt normativ. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, e cila ka evidentuar se kërkuesi mund të kundërshtojë me padi vendimin e KED-së që ndalon kandidimin e tij dhe brenda atij procesi mund të kërkojë shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit për Procedurat e Verifikimit.

17. Për sa më lart, Kolegji çmon se, ashtu siç kanë vënë në dukje gjykatat e zakonshme, mënyra e zgjedhur prej kërkuesit për të kundërshtuar ligjshmërinë e akteve normativ dhe më pas kushtetutshmërinë e tyre, pa kundërshtuar njëkohësisht edhe aktet individuale të dala në zbatim të tij (vendimet e ndalimit të kandidimit), nuk justifikon interesin substancial të tij për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe vetë aktet normative, ndaj ai nuk legjitimohet *ratione personae*.

18. *Së dyti*, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar për herë të tretë Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke parashtruar në thelb të njëjtat pretendime për liritë dhe të drejtat themelore. Për dy ankimet e para kushtetuese, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me të njëjtën linjë arsyetimi, sipas së cilës kërkuesi nuk mund të kundërshtojë aktet ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave është disponuar vendimi për kualifikimin ose ndalimin e kandidimit të tij, pasi akti i cili prodhon efekte të drejtpërdrejta dhe individuale është pikërisht ky i fundit, i cili duhet t'i nënshtrohet kontrollit nga gjykatat e zakonshme dhe vetëm pasi vendimet gjyqësore të jenë përfundimtare ai mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual.

19. Në këtë pikë Kolegji thekson se rregulli i parashikuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të Ligjit Organik të Gjykatës (*shih paragrafin 10 të vendimit*) synon të garantojë sigurinë juridike, duke parandaluar kërkesat drejtuar Gjykatës për rishqyrtimin e vendimmarrjes së mëparshme të saj nga të njëjtët kërkues, për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat pretendime. Në këto lloj rastesh merr rëndësi të analizohet thelbi i kërkesës, me qëllim për të evidentuar nëse ajo përmban ndonjë informacion, fakt ose rrethanë të re, e cila nuk është shqyrtuar më parë nga Gjykata (*shih vendimin nr. 57, datë 20.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës*). Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji nuk konstaton në ankimin e tretë ndonjë rrethanë faktike ose juridike të re në lidhje me objektin dhe shkakun e kërkesës dhe as ndonjë argument shtesë, arsye për të cilat mund të justifikohet një rishqyrtim i çështjes së kërkuesit. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim, për shkak se kërkimet e tij kanë qenë objekt i dy vendimeve të mëparshme të Kolegjit të Gjykatës.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “b” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.